



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGIJË
BORDI

VENDIM

Nr. 224, Datë 09.11.2021

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 216, DATË 11.10.2018
MBI TRANSFERIMIN E LICENCËS PËR OPERIMIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË
ENERGIJË ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË OPERATORI I SHPËRNDARJES SË
ENERGIJË ELEKTRIKE SH.A. (OSHEE SH.A.), ME NR. 250, SERIA P14SH, MIRATUAR
ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERVE TË ERE-S NR. 96, DATË 27.10.2014, TEK
SHOQËRIA "OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES" SH.A. (OSSH SH.A.), E
VLEFISHME DERI ME DATË 27.10.2044**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, *Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*; nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 09.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.139/4 prot., datë 02.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “ *Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018 mbi transferimin e licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të Shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria p14sh, miratuar me vendimin e bordit të komisionerve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, te shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.), e vlefshme deri me datë 27.10.2044”*,

Konstatohet se:

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018, shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. i është transferuar licenca e Operimit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, të shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, Seria P14SH, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, e vlefshme deri më datë 27.10.2044.
- Kushti i pikës 2 i vendimit të bordit të ERE-s me nr.216/2018, kërkon që: 2. *Shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.), të paraqesë në ERE listën e personelit sipas profilit në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, pasi të përfundojë transferimi i personelit për këtë shoqëri “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.), nga struktura përkatëse.*

- Kushti i sipërcituar është miratuar në zbatim të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, e cila konkretisht në nenin 9, pika 2, gërma “e” kërkohet: “Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse...”
- Në kuptim të sa më sipër, shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. me shkresën nr. 8754/2 prot., datë 20.10.2021, protokolluar në ERE me nr. 973/1 prot., datë 22.10.2021, ka bërë me dije se me Vendimin e Këshillit të Administrimit nr. 9, datë 31.12.2019, është miratuar në parim organigrama e shoqërisë OSSH sh.a. dhe me Vendimin e Këshillit të Administrimit të saj nr. 20/1, datë 09.12.2020 është miratuar struktura organizative e shoqërisë OSSHE sh.a. sipas organigramës që ka përcjellë bashkëlidhur edhe në ERE me një numër prej 5837 punjonjësish.
- Me plotësimin e kushtit nga shoqëria, kjo e fundit rezulton me një dokumentacion të plotësuar tërësisht.
- Në nenin 113 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të ndryshimit të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë subjektin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.